

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVES

Viktor Fridmën (SHBA)

**GJORGJI PULEVSKI, FJALORËT E TIJ
DHE RILINDJET KOMBËTARE SHQIPTARE
E MAQEDONE**

**Separat nga libri „Konferenca shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes
shqiptare të Prizrenit”**

**— Nga tubimi shkencor —
(Prishtinë, 6—7 qershor 1978)**

Prishtinë, 1990

245

Viktor Fridmën (SHBA)

GIJORGJI PULEVSKI, FJALORËT E TIJ
DHE RILINDJET KOMBËTARE SHQIPTARE
E MAQEDONE*

Formimi i Lidhjes së Prizrenit më 1878 ishte një ngjarje me rëndësi për zhvillimin e kombit shqiptar dhe gjuhën shqipe. Shikuar më gjerësisht, kjo ngjarje ishte rrjedhim i ringjalljes së ndjenjës kombëtare dhe i formimit të gjuhëve letrare jo vetëm në Ballkan, por edhe në vendet e tjera të Evropës, gjatë shekullit nëntëmbëdhjetë. Maqedonët ishin një nga popujt e Ballkanit që luftuan për çlirimin e tyre kombëtar dhe gjuhësor gjatë kësaj periudhe, dhe fakti se të dy gjuhët kishin qenë në një kontakt të ngushtë shumë shekuj me rradhë, ishte krejt e arsyeshme të dukeshin individë, aktiviteti i të cilëve do të lidhej me këtë kontakt. Një prej këtyre individëve ishte edhe figura e shquar e historisë maqedone Gjorgji Pulevski.

Pulevski u lind në gjysmën e parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë në fshatin Galicnik, në rrethin e Dibrës, vend ky ku kishte një kontakt të ngushtë gjuhësor slavo-shqiptar, dhe ku Pulevski me siguri do ta ketë mësuar shqipen. Madje është tejet e mundshme që ai të ketë marrë pjesë në kryengritjen e viteve 1845—1846 afër rrethit të Gollobërdos (Ristovski 1974: 6). Duhet gjithashtu se ai mbledhi edhe këngë popullore shqipe (Ristovski 1974: 118 n. 33). Gjatë udhëtimeve të tij, Pulevski i mësoi edhe gjuhët e tjera të Ballkanit, dhe më 1873 botoi veprën e tij të parë: një *Fjalor shumë gjuhësh: maqedonisht, shqip, turqisht dhe greqisht*. Ky fjalor dhe versioni i tij i dytë: *Fjalor trigjuhësh (maqedonisht, shqip, turqisht)* i botuar më 1875, ka rëndësi të veçantë, jo vetëm për zhvillimin e kombit maqedon dhe gjuhës maqedone, por edhe për studimet ballkanistike dhe dialektologjinë në përgjithësi, si dhe për pikëpamjet shoqërore të kësaj periudhe historike.

Kështu, për shembull, vetë emrat e gjuhëve që figurojnë në titujt e faqeve të para të librave flasin për raportet maqedone-shqiptare të kësaj kohe. Si maqedonët ashtu edhe shqiptarët has-

* Dëshiroj t'i shpreh mirënjohje prof. Erik Hampit (Eric Hamp) dhe Kostas Kazazis, për ndihmën e tyre në punimin e këtij artikulli. Të metat janë, natyrisht, vetëm të miat.

gabllim 122
shk. f. 95

nin në pengesa të mëdha sa i përket zhvillimit të tyre nën Perandorinë Otomane të shekullit nëntëmbëdhjetë: maqedonasit shtydonski „serbisht-maqedonisht”, mirëpo qëllimi i tij i vërtetë del shqiptarët nga turqit, e në jug (shqiptarët orthodoksë) edhe prej grekëve (Friedman 1975; Skendi 1964 : 314 — 315, 1967 : 111 — 128, 366 — 390). Meqë Pulevski i botoi fjalorët e tij në Beograd, ai që i detyruar t'i marrë parasyshë raprezaliet serbe ndaj popullit shqiptar, dhe mu këtu iu desh njohja e gjuhës shqipe. Në fjalorin e tij të parë ai e quan gjuhën sllave, gjuhë në të cilën edhe shkruan, *srpsko-albanski* „serbisht-shqip” e jo *arbanski-arnautski* (shqip-shqip), me anë të së cilës dëshiron të theksojë natyrën autoktone të gjuhës shqipe. Në fjalorin e tij të dytë, në shtyllën mbi gjuhën sllave, në faqen e parë të librit, gjuhën sllave e quan *s. makedonski*, me çka do t'u bëjë me dije autoriteteve serbe *srpsko-makedonski* „serbisht-maqedonisht”, mirëpo qëllimi i tij i vërtetë del në shesh në shtyllën mbi gjuhën shqipe, ku ai shkruan *skiništ-makedonise* „sllavisht-maqedonisht”.¹ Versioni i tij i dytë ka rëndësi të veçantë meqë paraqet mendimin e parë të haptë të shkruar të seperatizmit gjuhësor maqedon (Friedman 1975 : 89, poashtu Ristovski 1974 : 97, 110—111). Kështu, në këto ditë të hershme të zhvillimit të përbashkët, gjuha shqipe dhe maqedonishtja u lidhën ngushtë me fjalorët e Pulevskit.

dhe
Stamatovski
(1971)

**
(dy fje
stypii)

Pjesa sllave e fjalorëve të Pulevskit është trajtuar nga Ristovski (1974) dhe është komentuar nga Koneski (1967 : 257—260). Rëndësia e pjesës së gjuhës turke të fjalorit si burim për studimin e dialekteve të Rumelisë është theksuar nga Hazai (1963). Pjesa e fjalorit të Pulevskit që ka të bëjë me gjuhën shqipe, ndërkaq, nuk është studiuar. Për të bërë një analizë të hollësishme të këtyre teksteve dhe për të caktuar shkallën e realitetit dialektik të këhës dhe trevës së Pulevskit, është e domosdoshme të krahasohet gjuha e fjalorëve në tërësi me dialektet ekzistuese të trevës së Dibrës. Meqenëse kjo punë s'është pikësynim i këtij punimi, atëherë do të mjaftonte të ndalemi vetëm në shqyrtimin e disa problemeve.

Për këtë qëllim, kumtesa organizohet në këtë mënyrë: trajtohen cilësitë fonologjike më të shënuara në të dy parathëniet e fjalorëve të Pulevskit dhe zihen ngoje disa çështje morfologjike, sintaktike dhe semantike që gjenden atje; ky trajtim ndiqet nga një shtesë me transliterim të teksteve shqipe të të dyja parathënieve (në bazë të fotokopjeve të Hazait [1963]), me përkthim anglisht dhe me një tabelë të transliterimit të përdorur në këtë kumtesë. Duke i studiuar këto tekste, duhet të kemi parasysh se

¹ Ai shkruan gjithashtu *slavjano-makedonski* në pjesën mbi gjuhën sllave në faqën 40 të fjalorit (Ristovski 1974 : 83 n. 2).

² Parathënien e fjalorit të vitit 1973 e quan „*Parifolmat*” dhe e ka ndarë në dy pjesë, I dhe II. Në fjalorin e vitit 1875 parathënien e quan *Kuvend*. Pas gjithë fjalëve të cituara në këtë punim do të pasojë paraqitja e tyre në tekstin e Pulevskit duke përdorur këtë sistem: I për pjesën e parë të parathënies së vitit 1873, II për pjesën e dytë të parathënies së vitit 1873, K për parathënien e vitit 1875, dhe një numër arab që tregon rreshtin në

Pulevski ishte murator dhe jo dijetar, si edhe se ai ishte auto-didakt (Koneski 1967 : 157, 1974 : 58). Për këtë arsye, në gjuhën e tij gjenden gabimet dhe paqëndrueshmëritë që mund të priten nga një njeri në gjendjen e tij.³ Sidoqoftë, tekstet e tij kanë një vlerë të madhe si dokumente historike që e tregojnë karakterin e shumëgjuhësisë ballkanike, dhe sidomos të dygjuhësisë shqiptaro-maqedonase, gjatë periudhës së rilindjeve kombëtare të të dyja gjuhëve.

Duke e trajtuar fonologjinë e veprave të Pulevskit, çështja më e rëndësishme është drejtshkrimi i tij. Në atë kohë as maqedonishtja as shqipja s'kishin një drejtshkrim të caktuar, sadoqë maqedonishtja e kishte traditën e qartë që shkonte drejt përdorimit të alfabetit cirilik, kurse zgjedhja e alfabetit për gjuhën shqipe ishte një çështje më e koklavitur (shih për këtë Skendi 1960). Pulevski e ka përdorur alfabetin cirilik për të gjitha gjuhët në fjalorët e tij, dhe derisa kjo ishte një përfitim i qartë për studimin e turqishtes së Rumelisë së kësaj periudhe, sepse kështu tregohen zanoret, nga ana tjetër ishte një vështirësi për shqipen, sepse Pulevski nuk e ka përshtatur alfabetin për të shënuar tingujt e gjuhës shqipe me uniformitet.⁴ Si u tha më lart, në fund të kësaj

parathënien e cekur, p. sh. (II, 23) do të thotë „rreshti 23 i pjesës së dytë të parathënies së vitit 1873”. Pas trajtave të cituara, zakonisht, pason trajta përkatëse në gjuhën e njësuar shqipe, së paku të paraqitjet e para. Jam ruajtur që të mos i shënoj të gjitha fjalët. Kuptimi i tyre mund të gjendet i përkthyer në shtesën e punimit.

³ Me këtë rast, na duhet të zëmë ngoje pikësimin, ndarjen e fjalëve, dhe përkthimin. Siç e përmendëm edhe më parë, Pulevski nuk kishte bërë shkallim të rregullt. Si rezultat, pikësimi i tij është krejtësisht arbitrar, ndaj dhe mund të bazohemi në të. Poashtu, edhe në ndarjen e fjalëve ai është jokonsekuent — ngandonjëherë ndarja është leksike, ngandonjëherë në bazë të theksit, ngandonjëherë asnjera prej këtyre — sa që gjatë citimit të trajtave të ndryshme jemi detyruar ta marrim me mend ndarjen e saktë të fjalëve për t'iu shmangur shpjegimeve plotësuese. Sa i përket përkthimit të anglishtes, lipset cekur se për shkak të fakteve të lartë përmendura dhe faktit tjetër se njohja e shqipes, e greqishtes dhe e turqishtes nga ana e Pulevskit ishte e pamjaftueshme dhe për hirë të autoriteteve të Beogradit ai u orvat të shkruante parathënien e gjuhës sllave në serbishte, të cilën gjithashtu nuk e njihje si duhet, përmbajtja e vërtetë e parathënieve të Pulevskit nuk është krejtësisht e qartë. Gjatë përkthimit tim, kam shfrytëzuar tekste të ngjashme si dhe përkthime maqedone të teksteve serbe nga Ristovski (1974 : 35—36, 83—84). Megjithatë, si në përkthimet e mia, dhe të Ristovskit, mund të gjenden fragmente tekstesh që disi ngelin të paqartë (krahaso Ristovski 1974 : 36. 1, 43 n. 8).

⁴ Duhet theksuar se edhe ortografia e Pulevskit është jo konsekuente dhe e larmishme në pjesën maqedone të fjalorëve, e veçmas në paraqitjen e [t, l, l', n', j] si dhe në pikësim dhe në ndarjen e fjalëve (Ristovski 1974 : 43n. 8; 50n. 11; 85n. 6; 86n. 7, 8, 10; 87n. 11, 13). Gjithashtu duhet përmendur gabimet tipografike që dalin në tekstet origjinale: *prifti* duhet të jetë *prifti* (I, 4), *vhtui* duhet të jetë *vetui* (I, 9), *nuh* duhet të jetë *nuk* (I, 23), *kuvendeim* duhet të jetë *kuvendoim* (II, 2) (me sa duket bazuar në (II, 14)), *më* duhet të jetë *me* (II, 30), *makedenise* duhet të jetë *makedonise* (K, 34) (bazuar në titullin e faqes së parë), *gjuka* duhet të jetë *gjuha* (K, 38). Por mund të ndodhë që edhe shumë veçori të tjera të teksteve të Pulevskit të jenë gabime tipografike, por natyra e gjuhës dhe ortografisë së tij është e tillë sa që njeriu e ka vështirë të përcaktojë shkallën e përpikshmërisë.

kumtese gjendet një tabelë që e tregon alfabetin e Pulevskit dhe sistemin e transliterimit të përdorur këtu, sepse drejtshkrimi është dëshmia e vetme e dialekteve që Pulevski i dinte, dhe sepse drejtshkrimi i tij është i paqëndrueshëm, dhe për arsye të faktorëve të lartpërmendur që na kufizojnë, duhet të kufizohet analiza, vijuese me një theksim të çështjeve më të rëndësishme.

Për sistemin vokalik të gjuhës shqipe, i vetmi problem me rëndësi është të paraqiturit e *e*-së pazëshme [ë], jo pse kjo përshkon pothuajse tërë materialin, por nga fakti se kjo ndikon në trajtimin e morfologjisë, e veçmas në sistemin nominal. Problemi kryesor konsiston në faktin se Pulevski përdor *a*, *e*, dhe ndoshta *i*, dhe gjithashtu shenjat ", ' , dhe ø vetëm për këtë tingull.⁵ Si rezultat i kësaj larmie, njeriu e ka vështirë të kuptojë nëse ortografia e Pulevskit paraqet një të solme dialektore apo mosnjohje dhe mospërfillje të ortografisë. Duke studiuar të shkruarit e [ë]-së mund të veçojmë këto tri pozita: fundore, me [r], dhe gjetiu.

Problemi i shqiptimit të [ë]-së në fund të fjalës bëhet edhe më i paqartë nga se Pulevski në vend të *ë*-së përdorte zakonisht " ose ' në fund të shumicës së fjalëve që mbarojnë me bashkëtingëllore në I dhe II por ø në K. Kështu mund të hasim *duhet*" (duhet) (I, 3), gjithashtu *šum*" (shumë) (I, 1) dhe *un*" (unë) (II, 19), por edhe *jan* (janë) (I, 21), gjithashtu *zot* (zot) (II, 16), ndërkaq ai shkruan *duhet* (K, 2), *šum* (K, 1), *un* (K, 28), etj. Megjithatë, Pulevski përdor edhe *e* në këtë pozitë, p.sh. *ašte* (është) (K, 2), krahaso gjithashtu *er*" (herë) (II, 6), *er* (K, 27), *ere* (II, 15).

Problemi i trajtimit të segmentit të paraqitur me [ër] në gjuhën letrare komplikohet edhe më tepër nga se kjo luhet dhe jokonsekuencë mund të pasqyrojë një veçori të së folmes së Dibrës, në të vërtetë metatezën e [ër] në [re], p.sh. *për* bëhet *prë/pre* (Eric Hamp: vërejtje personale). Pulevski përdor këto forma grafike: *r*, *er*, *re*, *r*, dhe ndofta "r dhe ar, p.sh. *pr*" (për) (I, 17), *pr* (II, 2; K, 35), *pre* (I, 1; K, 26 dhe gjetiu), *çeter* (tjetër) (K, 9 dhe gjetiu), *çetr*" (I, 17), poashtu krahaso *çetri* (II, 7) por *çeteri* (II, 28), *çetr*"ri (II, 20), dhe *napar* (nëpër).

Në vendet e tjera, [ë]-ja shkruhet zakonisht me *a*, ngandonjëherë me *e* ose ø dhe një apo dy herë me *i*, p.sh. *katu* (këtu) (I, 2), *und'et* (ungjët) (K, 4), *msoim* (mësojmë) (K, 13), *emin* (emër) (K, 38), krahaso gjithashtu *mpretenija* (mbretëria = mbretëria) (K, 51) dhe *tind'ajjeta* (tungjatjeta) (K, 46). Fjalët njërokshe në dhe të bëjnë pjesë gjithashtu në këtë dukuri, ngase janë të lidhura me theks (e në tekstet e Pulevskit, grafikisht) me fjalët që u paraprijnë. Në shumë vende të ndryshme të teksteve [ë]-ja paraqitet me ø, " , a, dhe e për të dy fjalët, e poashtu si ' dhe i për në.

Dukuritë tjera vokalice janë të shumta, të nduarnduarshme, dhe në shumë vende të paqarta që të mund të trajtohen këtu hollësisht. Këto dukuri përfshijnë trajtat tipike gegërishte të tipit

⁵ Shenja ø do të përdoret për të shënuar mungesën e rëndësishme (të ndonjë foneme).

NUK është
"i VETMI"
është më i
rëndësishëm,
por edhe
tjetër problem
kanë rëndësi.

Vetmi

(K, 53)

ü
(I, 7)

[i] përkundër asaj toskërishte [ë] dhe gege [â] përkundër asaj toskërishte [ë], p. sh. *ny* (nji=një) (I, 11 dhe gjetiu), *ni* (K, 27) dhe *ma* (mâ=më) (I, 1 dhe gjetiu),⁶ gjerë ke ato dukuri qendrore gege siq është mungesa e [û]-së, p. sh. *lipset* (lypset) (II, 21/22), *çis* (qysh?) (K, 20/21), *kyi* ([kji]) (ky) (I, 20 dhe gjetiu) mirëpo *dytis* (dytë) (K, 24,30) (krahaso Desnickaja 1968 : 189; Elezović 1949 : 111, 1950 : 47; Gjinari 1977 : 547), gjer ke ato dukuri tipike të Dibrës sic është diftongizimi i [e]-së dhe [i]-së në [ej] dhe ndërrimi i [a]-së në [e], p. sh. *vr'tej* (vërte) (II, 1), *zanatçej* (zanatçi), *çke* (çka) (II, 21) (krahaso Elezović 1950 : 6—7, Jokl 1915 : 73). Trajta *nanas* (nënës) (K, 12, 62) kundruall *nanas*" (II, 5/6) mund të përfaqësojë [â]-në në gegërishten verilindore dhe jugore (Gjinari 1966 : 84—85), shkrirjen e [a]-së dhe [o]-së së Dibrës (Gjinari 1977 : 547), ose labializimin e [a]-së së Galçnikut para [m]-së dhe [n]-së (Mladenov 1925 : 65) (shih poashtu Desnickaja 1968 : 181).

ë

Veçoritë e konsonantizmit të teksteve në fjalë janë gjithashtu të shumëllojshme. Është e qartë se mossauesi i Pulevskit që të dallojë [d]/[dh], p. sh. *ede* (edhë) (I, 6 dhe vende tjera), *deut* (dheut) (I, 17) dhe [t]/[th], p. sh. *dëite* (gjithë) (I, 23) pasqyrojnë mospërfilljen e ortografisë nga ana e tij. (Shkronja e fundit është kompensuar me përdorimin θ në K, përveç në trajtën *azit* (K, 49). Mosaftësia e tij që të dallojë [r]-në prej [rr]-së, p. sh. *marret* (marret) (K, 36) mund të ketë ndodhur për të njëjtin shkak ose për shkak se ky dallim nuk evidentohet në Dibrë (Gjinari 1977 : 547). Opozicioni [l]/[ll] paraqitet vazhdimisht në tekstin e tij të dytë, p. sh. *nal't* (naltë) (K, 49) dhe *Sultan* (sulltan) (K, 47). Në tekstin e parë [ll]-ja del njëherë në fund të fjalës, *dishepul*" (dishepull) (I, 5), ndërsa [l]-ja nuk paraqitet, p. sh. *folim*" (flasin) (II, 3), ndaj është vështirë të konstatohet nëse Pulevski ishte i vetëdijshëm për këtë dallim në atë kohë. Trajatat e shumta të Pulevskit për *nj*, p. sh. *nj*, *nj*, *nj*, *ni*, *ny*, *në*, si dhe trajtimi i [j]-së, pasqyrojnë probleme ortografike me të cilët ai ballafaqohej edhe në sllavishte (shih. n. 4).

S

Sa u përket dukurive konsonatike që figurojnë në tekstin e Pulevskit, pesë sosh mund të veçohen si tejet të çuditshme: mungesa e rrotacizmit, shurdhimi në fund të fjalës, shndërrimi i [h]-së në [f] ose zhdukja e saj, trajtimi i segmenteve fillestarë me nazale (mb, nd, ng), dhe i palataleve (gj, q, dhe poashtu tj). Është e arsyeshme që në tekst figurojnë shumë shembuj të [r]-së toskë kundruall [n]-së gege, p. sh. *emin* (emën=emër) (K, 38). Është interesant të theksojmë, sidoqoftë, se në tekste ka edhe shembuj të shurdhimit në fund të fjalës, veçori kjo e cila është tipike për

⁶ Edhe pse mund të jetë e diskutueshme, për shkak të moskonsekuençës së Pulevskit në paraqitjen e [ë]-së, të gjitha rastet e a-së mund të paraqesin [ë] ose [â], dhe fakti se në dhe të shkruhen në gjashtë mënyrë ndërsa më shkruhet vazhdimisht me *ma* dhe dallohej prej *me*-së, flet në favor të interpretimit të a-së si [â] ose si [a] e denazalizuar (krahaso Mladenov 1925 : 67).

Gjinari
1966:86

dialektin toskë (Elezović 1949 : 110), edhe pse mund ta ndeshim edhe në disa të foime të dialektit gegë (Gjinari 1966 : 85), p. sh. *pag's*" (pakëz) (I, 24), *pagë* (K, 59), *prđeč* (përgjegj) (K, 31), por edhe *mund*" (mund) (II, 11, 17). Edhe pse *h*-ja paraqitet në fjalën *duhet* dhe në trajtat e ndryshme të fjalës *gjuha*, ajo pasqyron një *f* të Dibres në *ndiji* (ndihi) (II, 12), *diftojet*" (ndihmohet) (II, 18/19), dhe *nojim* (njohim) (K, 12) por kalon edhe në \emptyset në fjalën *ekurit*" (hekurit) (I, 15) dhe rastet e shumta me *herë* (krahaso Gjinari 1966 : 85, 1977 : 547). Trajtimi i nazaleve nistore (fillestare) është i larmishëm: *mbuš* (mbushi) (II, 29; K, 23) mirëpo *baroj* (barojë) (II, 15), *baroim* (mbarojmë) (K, 15), *mretis* (mbreti) (K, 46, 49) mirëpo *mpretenija* (mbretëria) (K, 49/50); *ndiji* (II, 12) por *diftojet*" (II, 18/19); *ka* (nga) (I, 20 dhe gjetiu) mirëpo *nka* (K, 2 dhe gjetiu). Këto trajta paraqesin një përzierje të dukurive të Dibres dhe jashtë Dibres (shih Elezović 1949 : 114; Gjinari 1966 : 85, 1977 : 547). Trajtimi i palataleve është edhe më i komplikuar dhe më i larmishëm, p. sh. *d'ite* (gjithë) (I, 17) mirëpo *džite* (I, 24), *gjuha* (gjuha) (K, 1 dhe gjetiu) por *čuhat*" (gjuhëve) (I, 2), *čintin* (qintin) (I, 20) por edhe *grečišt* (greqisht) (K, 43). Siç duket, Pulevski ka ditur t'i dallojë palatalet e forta dhe të buta për shkak të egzistimit të tyre në gjuhën e tij amtare, është tejet e mundshme që përzirja e tyre në gjuhën shqipe shpreh shkrirjen e [gj]/[zh], [q]/[ç], karakteristikë kjo e dialektit gegë jugor (Gjinari 1966 : 85). Nënrimi i [tj] në [č] pasqyrohet në trajtat e ndryshme të fjalës *tjetër*, p. sh. *četer* (K, 9 dhe gjetiu) por jo edhe në *tin'atijeta* (tungjatjeta) (K, 46) (krahaso Elezović 1950 : 65, Gjinari 1966 : 85, Jokl 1915 : 73).

Morfologjia dhe sintaksa e teksteve në fjalë ofrojnë material të pasur për studimin e dialekteve dhe të kontaktit të gjuhëve. Probleme të këtilla siç janë: përdorimet e ndryshme të fjalës *po*, përdorimi i infinitivit toskë dhe gegë (*me dhe për të*), koha e ardhme e *do-së*, që në kohë të fundit është vërtetuar se është karakteristikë e gjuhës shqipe në përgjithësi e jo vetëm e dialektit toskë (Gjinari 1977 : 546), mbaresat e vetave në trajtat e shtjelluara dhe zgjedhja e temës të foljet jo të rregullta, përdorimi i *kyi*, *kyi* dhe *kji* për *ky*, *kjo*, *këtë*, dhe *këto* si dhe përdorimi i mundshëm i përcaktorit me trajtën e shquar, që zakonisht është veçori e të folmeve të Çamerisë dhe Arvanitikës (Hamp 1968 : 665), gjurmat e mundshme të lokativit të vjetër, problemet lidhur me rendin e emrave dhe cilësorëve dhe përdorimin e pjesëzave, fjalët enklitike, rasat dhe shqueshmëria, këto të fundit na dalin posaçërisht të komplikuar për shkak të moskonsekuencës së Pulevskit në paraqitjen e [ë]-së, për të cilën bëm fjalë më lart, janë ca prej çështjeve dhe temave që mund të jenë të leverdishme për një studim më të hollësishëm.

Në fushën e semantikës, ka një mori njësisish leksikore që meritojnë të shqyrtohen: gegizmat, p. sh. *vel* (K, 14 dhe gjetiu), toskizmat, p. sh. *pampor* (I, 15) (shih Mann 1943 : 345), *pastai* (K, 17) (shih Elezović 1950 : 121), kalket, p. sh. *pasñani* (I, 6) (nga greqishtja *o pasa enas*), huazimet, p. sh. *kata* (II, 10) dhe *pas*

(I, 6 dhe gjetiu) nga greqishtja *bugarise* (K, 37) që tregon trajtën serbe-maqedone me *u*, neologjizmat, p. sh. *skišmaja* (mungesë) (K, 24/25) (=nemanje?), dhe përdorimet e çuditshme, siç janë: *musaf* (II, 28/29) „Koran” për „libër”, etj.

Çdo përfundim lidhur me këtë punim mund të ketë vetëm karakter të përkohshëm. Ne vëmë në dukje dy tekste që mund të shërbejnë si një burim i begatshëm për studimin e mëtutjeshëm të kontaktit të shqipes me maqedonishten dhe të dialektologjisë gjatë periudhës së rilindjeve kombëtare dhe i vumë në dukje disa prej problemeve që kanë të bëjnë me analizën gjuhësore. Pos rëndësisë në sqarimin e çështjeve të cekura më lart, një analizë e hollësishme e këtyre teksteve do të ofronte të dhëna të vlefshme rreth mundësisë së unifikimit të gjuhës letrare shqipe, me kombinimin e elementeve gegë dhe toskë gjatë shekullit nëntëmbëdhjetë, që reflektohej atë botë jashtë qarqeve të shqipës letrare. Mbesim me shpresë se kërkimet e ardhshme do të plotësojnë detyrat dhe qëllimet, fillimet e të cilave vetëm janë shtruar këtu.**

(shih Demiraj 1959)

S H T E S Ë

PARIFOLMAT

- Dišme mašum", çuhat"
n" taš" vakt" prepaš-
nani, i duhet", site:
z. z. prifti, ederešpart",
5 premēštri, prej dišepul"
ede prepašnani mēšter"
zanatçej, ede t" çatr" t"
pas" nanj kuš", škoò n'
anat", vxtui, edeka, çonte
- 10 meata, n' ke, krkoje pas'
ny, puni t" veti, po i
upr' geça, pra, mašum"
prenërijat" škonnte anete
vetui, i duhet", sepse, pam-
15 porat" vromi ekurit", te-
li škrume ke afr'uan",
d'ite largi deut", pr' aštu
afri, na duhet", neve poj
dim", n" gurbetçijat", ede
20 mašum", folmat" ka kyj
kujan katu, sepse, kyj çin-
tin, veti, t"ške du het"
kaštu podim", ne nuh"
džite pra kapag's"

PARATHËNIE

- Njohja e shumë gjuhëve
në këtë kohë është e nevojshme
për çdonjeri, p. sh. Zotërinj.
prift dhe tregtar,
5 për mësuesin dhe për nxënësin,
dhe për çdokë (që është) mjeshtër
(ose) tregtar, dhe për të tjerët,
çdo kush që shkon në vende të
huaja
dhe ka lidhje/maqedhënie me ta.
- 10 (Dhe) për cilin do që do t'i
përgjigjet detyrës së tij
njerëzit që shkojnë jashtë
është e nevojshme, meqë va-
- 15 porat, hekurudha, tele-
grafi, i kanë shruar
të gjitha largësit e botës. Për
shkak të kësaj
afërsie, është e nevojshme që na të
dimë kur punojmë jashtë dhe
- 20 më shumë fjalë se ato
që janë këtu, sepse ky she-
kull kërkoi (tani ka nevojë?)
kështu që të dimë nëse jo
çdo gjë, së pakut pakëz (për çdo
gjë).

** Mbas leximit të kësaj kumtesë, Hasan Kelmendi vuri në dukje se janë disa të dhëna mbi gjuhën shqipe të Pulevskit në veprën e Prof. Eqrem Çabejt dhe në një artikull në *Bigorski Naučno-Kulturni Sobiri: Naučni Sobir I* (Gostivar, 1971): „Značajot na delot na Gorgi Pulevski — kao pret-hodnik vo kulturnata prerodba na albanskiot narod” të Petro Janurës (169—175). Në këtë artikull shënohet se gjuha e Pulevskit përfaqëson edhe disa trajta dialektore të Pologut dhe të Gostivarit.

II

Vr'tej nyje majleen^u u
coiti prtakuvendeim kur"
folim" megoja pra atare
neduhet" neve, shum" mot"

- 5 ede ton", te cuhe, te na
na", nyer", podfortoim"
pra kur ede cetri, pra ne
i duhet" n" pas" njani
ede kr'koje si ky^d letra,
- 10 pas" kije, kata si kuš"
jekijerç, mund" me kato-
folmat" mjaft mendifi.
sepse, džindet" ka pak", në-
ryi di, pokuvendoi, pra
- 15 ata ere, mjaft", pobaroj
t" vete site kuš" ke zot
mëstri skoï mund" ede n"
ma džan" kuitu poi dif-
tojet" ka kyï ny er" un"
- 20 poi shkruu ede cet"ri po-
çi letra, kakyl çke lip-
set" ede n" ma džan" kuitu.
Tašti nyer" rugdoni
me kyï ede nije fajtura,
- 25 k'rkude, site n', džan" kui-
tu ede n'drejt" arada pref-
to n" paras", me, folmat"
poinendo pra n çeteri mu-
safi doti mbuš" edet" tri-
- 30 ti, tekarte mëshkrumte te
drejt', poiškruu.

KUVEND

- Mašum gjuha, tadijm,
i ašte nkaduhet, prepas
vet njeri nka mate nal-
ti, d'erte mate und'et, a-
5 rada, cil'i poškoï naa-
na tevetui, nde moti so-
tis, kijo, kamça, ede nde
liberti paras.
- Çeter ekam kuvando-
10 va, sipoduhet, shum mot,
d'ertafortoim, ede gjuha
te nonas tonte, tatno-
fim, ede tat msoim, ajo
poduhet, prepas vet, ta-

II

- Vërtet është më lehtë për ne
të mësojmë të flasim kur
ne flasim me gojë (ushtrojmë),
por aherë
na duhet shumë kohë
5 edhe deri ta përvetësojmë gjuhën
tonë amtare,
pra sa më shumë për tjerët. Por
nëse
është e nevojshme për dikë
dhe ai kërkon këso librash
- 10 si kjo,
e prerë siç është kjo, ai mundet
t'i ndihmojë mjaft vetes me këto
fjalë,
sepse, ndodh që nëse
një person di të flasë pakëz,
15 atëherë ai do të përparojë mjaft
si ai që shkon tek zotëri
mësuesi (i cili) mundet gjithashtu
të ndihmojë në një kuptim më të
gjërë
së këtë, ndërsa unë
20 po shkruaj edhe një libër
tjetër, pos këtij (për të plotësuar)
atë
që mungon gjithashtu në një kup-
tim më të gjër.
- Tani për tani përdorni
këtë, dhe nëse është me të meta
25 kudoqoftë, si në kuptimin e gjerë
dhe i prerë (organizuar) në një
formë të drejtë
në librin e parë, do ta ndërroj atë
për fjalët e tjera në librin e ardh-
shëm, dhe unë gjithashtu do ta
plotësoj
në librin e tretë/qartazi (?), e do
ta
shkruaj me një drejtshkrim të
pastër.

BASHKËBISEDIM

- Që të dimë më shumë gjuhë
është nevojë për çdo
individ, prej klasës më të lartë
deri te më e ulëta,
5 i cili shkon ja-
shtë në kohë të sotme,
këtë e thashë edhe në
librin e parë.
- Kam thënë, tjetër,
10 se lipset shumë kohë
gjersa ta përforcojmë
gjuhën tonë të nënës dhe ta dimë
atë e ta mësojmë. Kjo
duhet për çdo individ për të

- 15 baroim, pse aštu pas,
mend, šindoši, krkoje,
por pastai, ede çeter
gjuha, paste duhet, ve-
tis, tamsoim.
- 20 Tretis kamea, poçi-
š ašte nde l'iberti pa-
ras škurt, ede faitun,
si dota mbuš nde l'i-
berti udutis, džiça ski-
šmaja, ede dota drito.
- 25 Apoherji, kurksužašt
nier, dohsend, duhet,
ajo ta sose, por un edža-
ta prebukur, kji l'ibret
udutis, çekaštu eškru-
va, preuprdžec n ksuzjašt
tem.
- Çepreaajo mbas gjuhate
škiništ; makedonise
- 35 eškruva, prse nde kji
skai nuk pou maret vešt
gjuha te bugarise, a po
kji gjuka, kište emin te
vetis, mijakise, cil'i-
- 40 poni, fol'mat epastr,
mbas cil'i jan ede l'i-
berta kišas, bjemun, nka
greçišt kišten bije
Kirili ede Međodije,
- 45 preherazi tona.
- Tind'atijeta mretis
imad, Sultan Abdul a-
ziz azamet, kaepe daš-
nimite nal't emretis,
- 50 mdžit kuš neraz, ndem-
pretenija temade, eti-
se, naskuš, tamsoim gju-
ha, naparte gjuha teve-
tis, ede çeter gjuha.
- 55 Portašti rugdoni
mekji çeter preajo, ede
kam kjerç, çastu, ede
nkašumsend ekuvandova
kapags, pse vocat, me
- 60 kndomea mbaskji, ede çe-
ter gjuha, tamsoim, apo-
ede gjuha veti inonaš
dot dritoin.
- 15 plotësuar, sepse kështu kërkon
çdo mendje e shëndoshë,
dhe pastaj edhe gjuhët e
tjera, sipas nevojës,
na duhet t'i mësojmë.
- 20 Së treti, thashë se
çkado që të jetë në librin e parë
shkurt dhe gabimisht
(se) do ta plotësoj në librin
e dytë, dhe të gjitha lësh-
met do t'i korrigjoj.
- 25 Ngase kur njeriu premtion
njëherë diçka, (atëherë) ai duhet
ta kryejë. Por mua po më duket
i përshtatshëm ky libri i dytë
- 30 për të shkruar kështu
si përgjigje e premtimit tim.
Kështu në gjuhën
slavo-maqedone
- 35 e kam shkruar, meqë në këtë
trëvë nuk kuptohet
gjuha bullgare. Dhe
kjo gjuhë e ka emrin e vet,
mijakjan, që
- 40 do të thotë „e folme e pastër” dhe
sipas së cilës janë
bërë librat e kishës
(përkthyer) nga greqishtja
prej Kiril dhe Metodije
- 45 për njerëzit tanë.
- Rroftë mbreti
Sultan Abdul A-
ziz Azamet. Ai i ka dhënë
mbretërisë së tij vullnet të lartë
që të gjithë njerëzit në
mbretërinë e tij,
secili prej nesh, do t'i mësojë gju-
hët sipas gjuhës sonë
e gjithashtu edhe gjuhët tjera.
- 55 Prandaj tani përdorni
këtë librin tjetër të ardhshëm,
meqë
unë kështu e kam prerë (planifi-
kuar) dhe
unë kam folur për shumë gjëra
nga pak, kështu nxënësit
duke lexuar në të do të mësojnë
edhe gjuhët tjera
dhe do të përmirësojnë gjuhën e
tyre.

TABELË

Pulevski	Transkripcioni	Pulevski	Transkripcioni
А	a	П	p
Б	b	Р	r
В	v	С	s
Г	g	Т	t
А ²	d	Ђ	ć
Б ²	d'	У	u
Е	e	Ф	f
(Ж)	ž)	Х	h
З	z	Ц	c
И	i	Ч	č
Й ¹	i	Џ	dž
Ј	j	Ш	š
К	k	Ђ ¹	"
Л	l	Ђ ¹	y
Љ ²	l'	Ђ ¹	'
М	m	Ђ ¹	ë
Н	n	Ө ²	θ
Њ	ñ		
О	o		

¹ Vetëm në tekstin e parë.

² Vetëm në tekstin e dytë.

BIBLIOGRAFI — BIBLIOGRAPHY

1. Demiraj, Shaban. 1959. *Disa shënime rreth lëvrimet të gjuhës shqipe gjatë shekullit XIX*. Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës: Seria Shkencat Shoqërore 13, 1. 49—79.

2. Desnickaja, A. V. 1968. *Albanskij jazyk i ego dialekty*. Leningrad: Nauka.

3. Elezović, Gl. 1949/50. *Znatnije razlike između dve grupe govora u arbanaškom jeziku: Gegiske i Toskiske*. Južnoslovenski Filolog 18.107—122.

4. Elezović, Gl. 1950. *Glasovne osobine arbanaškog dijalekta Debra i njegove okoline*. Beograd: Srpska Akademija Nauka. (Iz *Dijalektološkog zbornika*, Knj. XI).

5. Friedman, Victor A. 1975. *Macedonian Language and Nationalism during the Nineteenth and Early Twentieth Centuries*. *Balkanistica* 2.83—98.

6. Gjinari, Jorgji. 1966. *Dialektologjia shqiptare*. Tiranë: Universiteti Shtetëror. [1970. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës.]

7. Gjinari, Jorgji. 1977. *Résultats et problèmes de la dialectologie albanaise à la lumière des nouvelles données*. Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums. Innsbruck: Universität Innsbruck, 539—556. (Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft Sonderheft 41).
8. Hamp, Eric P. 1968. *La langue albanaise et ses voisins*. Actes du Premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes. Sofia: Bălgarska Akademija na Naukite. 663—668.
9. Hazai, G. 1963. *Rumeli ağzaları tarihinin iki kaynağı üzerine*. Türk Dili Araştırmaları Yıllığı Belleten 117—120g. (Türk Dil Kurumu Yayınları 234).
10. Jokl, Norbert. 1915. *Bericht über seine nordostgegischen Dialektstudien*. Anzeiger. Kaiserliche Akademie der Wissenschaften in Wien. Philosophische — Historische Klasse. Nr. XIII. 68—74.
11. Koneski, Blaže. 1967. *Makedonskiot Ğorgi (Ğorgo) Pulevski*. Za makedonskiot literaturni jazik. (Izbrani dela vo sedum knigi: Kn. 5). Skopje: Kultura. 253—265.
12. Koneski, Blaže. 1974. *The Image of Ğjorgji Pulevski*. Translated by Victor A. Friedman. *Macedonian Review* 4, 1. 57—59.
13. Mann, Stuart E. 1948. *An Historical Albanian-English Dictionary*. London: Longmans, Green and Co.
14. Mladenov, St. 1925. *Bemerkung über die Albaner und dans Alban-schen in Nordmakedonien und Altserbien*. Balkan-Archiv 1. 43—70.
15. Pulevski, Ğorgija M. *Odbrani stranici*. V. Ristovski 1974.
16. Ristovski, Blaže (ed.) 1974. *Ğorgija M. Pulevski — Odbrani stranici*. Skopje: Makedonska Kniga.
17. Skendi, Stavro. 1960. *The History of the Albanian Alphabet: A Case of Complex Cultural and Political Development*. Südostforschungen 19. 263—284.
18. Skendi, Stavro. *The Emergence of the Modern Balkan Literary Languages — A Comparative Approach*. Die Kultur Südosteuropas ihre Geschichte und ihre Ausdrucksformen, Gunter Reichenkron & Alois Schmaus (eds.) Wiesbaden: Harrassowitz. 303—321
19. Skendi, Stavro. 1967. *The Albanian National Awakening: 1878—1912*. Princeton: Princeton University.

Victor Friedman

GJORGJ PULEVSKI,
SES DICTIONNAIRES ET LES RENAISSANCES NATIONALES
DES PEUPLES ALBANAIS ET MACÉDONIEN

Résumé

Cette discussion présente du point de vue albanologique les deux dictionnaires polyglottes du patriote macédonien Ğjorgji Pulevski de Galičnik. Les dictionnaires, dont le premier (1873) est macédonien-albanais-turc-grec et le deuxième (1875) macédonien-albanais-turc, illustrent bien l'importance des

1 pa pike
(TURKISH)

Ğ

A

Ğ Ğ
Ğ Ğ

Ğ Ğ

a

I

me shkrimet
← ordinare

rappports linguistiques entre ces langues balkaniques à l'époque où les renaissances nationales des peuples albanais et macédonien prenaient forme. Le corps de cette discussion traite des problèmes de l'analyse dialectologique des textes albanais des dictionnaires, en adressant surtout leurs introductions respectives, qui sont présentées dans l'appendice de l'article. Une importance particulière est accordée aux problèmes de la phonologie, de la morphologie, de la syntaxe, et de la sémantique, avec un appui supplémentaire sur la représentation orthographique des phénomènes phonologiques.

h